

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 31 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Sigurisht që është një sforco e jashtëzakonshme të përmbash bezdinë dhe pseudoneverinë, kur sheh se si një ekip qeveritar përpiqet të shesë hiçin për diç. Është shumë e qartë se kemi të bëjmë me një akt normativ, i cili s'bën as më shumë e as më pak se sa akomodon problemet e një keqqeverisjeje në kufijtë e një dizastri të vërtetë. Raportet janë shumë të thjeshta. Në paketë dy janë gjërat themelore: 200 milionë euro shkojnë për energjinë, ndërsa 60 milionë dollarë shkojnë për atë që quhet paketa e rezistencës sociale, një pjesë të cilave janë shpenzime të parashikuara në buxhet, siç është indeksimi i pagave dhe pensione e të tjera.

Të ulërisht e të bërtasësh e t'u kujtosh se u ke dhënë një pjese të pensionistëve njëmijë lekë të vjetër në ditë, duhet të kesh pacipësi të madhe ta bësh një gjë të tillë me gojën plot e të tallësh me mjerimin deri aty ku s'mban. Megjithatë, detyra propagandistike është dhënë, mesazhi në inbox është i unifikuar dhe, kur paturpësia kulmon deri në pikën kur flasim për 8,1% rritje ekonomike, ndërkohë që kemi qindra e mijëra qytetarë, të cilët torturohen nën trysinë e çmimeve, që janë dukshëm ekstremisht të larta, sigurisht që kurajë kalon gjithë kufijtë dhe bindesh në mënyrë të pakthyeshme që shpresa për të pasur një reflektim është zero. Këto janë fakte. Kushdo që do të shpikë fakte të tjera, nuk ka të tjera. Këto janë të shkruara e zezë në të bardhë po nga e njëjta qeveri, e cila do të mbrojë hiçin për diç. Është fare e qartë se ne duhet të marrim 200 milionë dollarë të tjerë, t'i vëmë për energjinë elektrike, mbasi vetëm në tre muajt e fundit, po në këtë sallë, janë marrë 300 milionë euro borxh e, meqë flitet për borxh, kemi një qeverisje, e cila ka shkëlqyer vetëm në një pikë: vetëm brenda 6-7 vjetësh ka marrë 2,3 miliardë euro borxh.

Ky është menaxhimi që i kanë bërë ekonomisë, që ka histori të tmerrshme korruptive, siç është afera e inceneratorëve, që nuk mbaron me inceneratorët, sepse keni pasur mundësi të shikoni si thellohet edhe në mjaft sektorë të tjerë, e do të kemi plot ditë të tjera kur do ta shikoni se sa do të thellohet. Në këtë drejtim shkëlqejnë vërtet shumë. Dëgjova sot këtu, duke filluar që nga Kryeministri e të tjerë me radhë, një kor. Shikoni, - tha-, se si vepron drejtësia. Ky është standardi i lartë i drejtësisë që vumë. Meqë jemi te standardi i drejtësisë, le t'jua kujtojmë një herë e përgjithmonë: në këtë sallë parlamenti, në të gjitha rastet kur ka pasur kërkesa për heqjen e imunitetit, dhënie mandatesh për të lejuar arrestimin e të tjera, janë miratuar automatikisht. Rekordin historik, si të asnjë maxhorance tjetër, e kanë vetëm këta, kur ndaluan arrestimin e ishministrit Tahiri. Ky është standardi që kanë. Këto janë faktet. Le të sjellin një fakt të dytë kur kjo sallë ka guxuar ta bëjë këtë gjë.

Janë kërkuar imunitete edhe më përpara për ministra, zëvendëskryeministra e lloj-lloj, por standardin për të kthyer mbrapsht kërkesa e kanë vënë vetëm këta. Meqë bëhet fjalë për drejtësinë e re, ajo fillon

të bëjë sikur vepron pas një viti. Jemi më 31 mars. Një vit rresht ka denoncime, tri kallëzime, të cilat ishin edhe shumë të lehta për drejtësinë. Do të mjaftonin edhe indicie, por ishin kallëzime me fakte, me shifra, me emra, me mbiemra. Asnjë nga ata nuk është arrestuar. Ata që bënë të rrjedhin dhjetëra milionë. Asnjë nga krerët, sepse milionat nuk do të rridhnin për këta bishtat që fusin në burg, po të mos miratonin kryeministri, ministrat e kryetarët e bashkive me radhë. Po nuk është asnjëri, fare-fare asnjëri. Janë bishtat gjithmonë. Ne jetojmë në Shqipëri dhe populli ynë e ka një shprehje të bukur, që thotë: “Demi kapet nga brirët.” Ky demi i drejtësisë së këtyre është kapur nga bishti dhe nuk vete dot atje. Sepse duhet të ngopim opinionin me bishta, me nga një bisht në çdo trekatër muaj, ndërkohë që ka një vit që dosjet me kallëzime janë atje. Prandaj, le të mos flasim më për drejtësinë e re.

Fatkeqësisht, kemi një drejtësi të kapur për fyti e të telekomanduar, sa që e parathonë qysh më përpara Edi Rama e të tjerët, që do të ketë ngjarje, do të ketë arrestime, pastaj veprojnë këta. Njëlloj siç bënin edhe për pandeminë, që më përpara fliste Kryeministri, e më pas fliste Komiteti i Ekspertëve, për fat të keq kolegët e mi. Është fare e qartë se një nga hallet e mëdha, që ne detyrohemi ta paguajmë me para gjaku të njerëzve të thjeshtë, është energjia. Një menaxhim kriminal. I kanë dalë gurët Fierzës, sepse në vitin kur nuk ishim në krizë, por ishim me mbiprodhim, po provojmë krizën më të rëndë që ka ekzistuar ndonjëherë. Nuk jemi vend i varur nga energjia, si të tjerët, ne kemi prodhim shumë të rëndësishëm dhe konsistent, që mbulon shumicën dërrmuese të nevojave të vendit dhe sot jemi në krizë energjetike, prandaj po miratohen qindra e miliona lekë dhe fatura do të vazhdojë të rritet dhe mund të shkojë deri në 1 miliard euro. E përse? Sepse doni të shisni lirë me ndërmjetës, që t’ju kthejnë sërish paratë dhe sot dilni në treg për të blerë me 7- fishin e çmimit.

Pra, për gjëra që janë kaq të thjeshta, këta dalin dhe na thonë se nuk janë të vërteta. Po këto janë fakte, është e zeza në të bardhë. Nuk po shpikim fakte, po themi vetëm këto që kanë ndodhur. Të duartrokasësh dhe t’u thuash shqiptarëve se po ju ndihmojmë duke ju dhënë 1000 lekë të vjetër vetëm për disa pensionistë, sepse 240 mijë pensionistë të tjerë nuk përfitojnë, sikur këta nuk shkojnë në dyqan dhe blejnë me çmime të ngritura, çmimet për këta janë të lira! Po flas edhe për një problem tjetër shumë të rëndësishëm, duke nisur nga Kryeministri dhe të gjithë me radhë thonë: të mos flasim për prekje të taksave dhe të tatimeve. Po çfarë është kjo qeveri fanar? Mirë, krenohuni që jeni fanar, por jeni fanar i një paturpësie që nuk ka ku të shkojë më, të tërë pa përjashtim. Kryeministri na përmendi Australinë, unë po i përmend Zelandën e Re, që është pak më poshtë, e cila, me ndërhyrjen që bëri, përgjysmoi vetëm taksat që kishin të bënin me karburantin, meqenëse do një lajm të freskët, se këtij çfarë i thonë thotë, nuk është se i punon mendja shumë.

Të gjithë këta ndërhyjnë ose tek akciza, ose tek TVSH-ja e të tjerë. Po çfarë qeverie është kjo, reaksionare? Qeveri proruse është kjo? Të vetmen qeveri proeuroatlantike kemi këtë, e cila e zëvendëson këtë mekanizëm transparent, pra qoftë dhe në mënyrë të përkohshme, për të ndërhyrë në taksa dhe tatime, me bordin e transparencës, pra pazari i gjësë: ma jep ta jap, sot e bëjmë kaq, nesër e bëjmë aq. Ndërkohë që një masë transparente, e barabartë për të gjithë, që respekton edhe diferencat që ekonomia e tregut na jep, janë taksat dhe tatimet. E duan një përgjigje të gjithë shqiptarët. Çfarë ka më shumë ekonomia maqedonase dhe malazeze? Janë ekonomi më të mëdha, më të fuqishme? Kanë akses më të madh? Kanë më shumë burime natyrore? Çfarë kanë më shumë se Shqipëria? Asgjë. Por kanë një diferencë të madhe, kanë një qeveri më të përgjegjshme, që mendon për njerëzit dhe jo qeveri

që paturpësisht i rrjep të gjallë njerëzit. Karburanti, kur në Shqipëri kushtonte 245 lekë të vjetër, në Maqedoni kushtonte 166 lekë të vjetër, pra 35% më pak; e njëjta gjë ishte edhe në Malin e Zi. A ka përgjigje për këtë? Kjo është përgjigjja.

T'i lëmë përrallat, sepse njerëzit nuk kanë nevojë për to. Gëzoheni se keni një qeveri kaq të dashur dhe nuk ka turp të bëjë propagandë gjithë ditën! Kjo është detyra e shtëpisë: kur nafta në Shqipëri ishte 245 lekë në Maqedoni ishte 160 lekë dhe në Mal të Zi është 167 lekë. Ekonomia shqiptare, në volume e në të gjitha, është më e madhe se e tyre, deti është në Shqipëri, nuk është në Shkup, megjithatë çmimi i karburantit është më i lartë këtu. Si doni t'i bindni njerëzit? Të tjerat janë llafe. Dëgjoj edhe ministra, që janë të rinj në moshë, të cilët i bëjnë shërbim një dëngle kaq të paturp dhe e konsumojnë veten e tyre në mënyrë qesharake. Këto janë fakte kokëforta dhe nuk u ikim dot. Si përfundim, paketa vuri dorë mbi arsimin, vuri dorë mbi emergjencat civile, vuri dorë në çdo sektor, por nuk preku pagesat e rregullta për inceneratorët, që të mos flasin ata që kanë ikur dhe janë në arrati. Pra, nuk preku asgjë nga ato që grabiten çdo ditë, nuk preku taksat, në mënyrë që pazari me oligarkët të vazhdojë. Ky është një akt normativ turpi dhe jo një shërbim ndaj qytetarëve!